



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine

Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

01 Ref. Nr.01/97

Prishtinë: 29.12.2023

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në mbështetje të nenit 11, paragrafit 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10 dhe 11, të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), si dhe shtojca 12 e Rregullores (QRK) - nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

1. Shfuqizohet Rregullorja (MTI) Nr. 01/2014 për Kërkesat Themelore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Pajisjeve Elektrike Shtëpiake për Ngrirje, Frigoriferëve dhe Kombinimet e Tyre, në Lidhje me Kërkesat e Eficiencës së Energjisë.

A r s y e t i m

Rregullorja Nr. 01/2014 për kërkesat kryesore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike shtëpiake për ngrirje, frigoriferët dhe kombinimet e tyre, në lidhje me kërkesat e eficiencës së energjisë është pjesë e Programit për Eliminimin e Barrierave në Tregti 2021-2025, i miratuar nga Qeveria e Kosovës me Vendimin e dt. 22/16 të dt. 22.06.2021, dhe është shqyrtuar se a përmban barrierave në tregti apo masa me efekt ekuivalent kundrejt parimeve të nenit 34-36 të TFBE. Nga shqyrtimi rezulton se rregullorja nuk është në përputhje me *acquis* të BE-së sepse Direktiva 96/57/EC mbi Kërkesat e Eficiencës së Energjisë të Pajisjeve Elektrike shtëpiake për ngrirje, ftohje dhe kombinimin e tyre është e shfuqizuar dhe në vitin 2010 nga Rregullorja e Komisionit (EC) 643/2009 në lidhje me kërkesat e eko-dizajnit për pajisjet frigoriferike shtëpiake. Nga kjo rezulton që mospërputhja në zonën e harmonizuar konsiderohet si masë e efektit ekuivalent (pengesë për tregtinë) pasi që rregullat e tregtimit ndryshojnë nga rregullat që duhet të transpozohen plotësisht dhe të zbatohen.

Kjo fushë do të rregullohet me legjislacion të veçantë që rrjedh nga Ligji të ri për Eko-dizajn dhe Etiketimin e Energjisë që transponon Direktivën 2018/2022/EU dhe zëvendëson Ligjin ekzistues Nr. 06/L-079 për Eficiencën e Energjisë.

Në bazë të asaj që u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare.

Vendimi i dërgohet:

- *Kabinetit të Ministres;*
- *Zyra e Sekretarit të Përgjithshme;*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Arkivit të MINT.*